



Shpërthim në Pejë, lëndohen dy persona



LAJME TË FUNDIT

- Zyrtarët e VV-së nuk përtojnë të merren me...
- Zhduket një 14 vjeçar në Gjakovë
- Rrokulliset me motor, vdes burri në Novosellë të Prizrenit
- Fushë-Kosovë: Pas një mosmarrëveshje të prindërve rrihen mes...

14/08/2024 08:32



Një shpërthim ndodhi mbrëmë në rrugën “Halil Agusholli” në Pejë.

Kjo është konfirmuar edhe nga Policia e Kosovës, nga ku u tha se njësitë relevante policore në Pejë menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes ku edhe është kuptuar se nga shpërthimi janë lënduar dy persona.

“Aty është kuptuar se nga shpërthimi dy persona kanë pësuar lëndime trupore të njëjtit janë dërguar në spitalin rajonal në Pejë, e më pas janë transferuar në QKUK”,thuhet në njoftim.

Tutej u theksua se gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar:

Një armë AK-47

Tre karikator të së njëjtës armë

90 fishekë të kalibrit 72×39.

Me urdhër të prokurorit të shtetit rasti është cilësuar si : Shkaktim i rreziku të përgjithshëm si dhe mbajtja në pronësi, kontroll të paautorizuar të armëve.

“Rasti është duke u hetuar nga njësiti i Sektorit Rajonal për Hetime DRP Pejë”./Lajmi.net/

Më shumë nga uebi



E tepron Adelina Tahiri, shfaqet si ‘tigër’ në këtë

7 Standing Ab Exercises to Work Your Entire Core

Aeropiani i nisur nga Prishtina për në Gjenevë

VIDEO: Ragimi interesant i Leo Messit kur një tifoz

(The King's Slave...) MOANA MULAN CHAPTER 1

Artikuj të ngjashëm

August 14, 2024
Zyrtarët e VV-së nuk përtojnë të merren me statutet e Haradinajt,...

August 14, 2024
Zhduket një 14 vjeçar në Gjakovë

August 14, 2024
Rrokulliset me motor, vdes burri në Novosellë të Prizrenit

August 14, 2024
Fushë-Kosovë: Pas një mosmarrëveshje të prindërve rrihen mes vete edhe fëmijët,...

August 14, 2024
PDK thërret konferencë për media

August 14, 2024
Pikat e rendit të ditës për mbledhjen e Qeverisë